



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 30507

Më: 28 shkurt 2022

P r i z r e n

Në bazë të nenit 52 paragrafit 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 59 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet me 08 mars 2022 (e martë), në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, duke filluar në orën 10:00. Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 11 shkurt 2022;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit, për formimin e Komisionit Përzgjedhës;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – vendim për miratimin e Draft-Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2022;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e tre (3) anëtarëve të Këshillit nga banorët e fshatit Zym i Hasit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen dhe delegimin e përfaqësuesve nga Ekzekutivi dhe Kuvendi i Komunës, në Asociacionin e Komunave të Kosovës;
7. Informatë rreth Raportit të realizimit të buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2021;
8. Informatë rreth Planit të Punës të Zyrës së Prokurimit për vitin fiskal 2022;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zgjedhjen e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete;
10. Shqyrtimin dhe miratimi i propozim- rregullores për menaxhimin e mbeturinave

Kryesuesja e KPF-së
Antigona Bytyqi

